

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Zgjerimi / *el-Bastu* / البَسْتُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"يَذَرُوكُمْ فِيهِ"

"... Ai ju shumëfishon kështu..."¹ (esh-Shuraa, 11)

Zgjerimi ndodh atëherë kur Ai harmonizon të jashtmen e robit me shenjat treguese të dijes dhe vesh të brendshmen e tij me petkun e devocionit. Këta janë njerëz të maskimit (fshehjes)². Këtyre u është zgjeruar për tri qëllime dhe për secilin qëllimin ka një grup që i kushtohet.

Një grupi i është zgjeruar si mëshirë ndaj krijesave. Të këtillët janë të këndshëm ndaj krijesave³ dhe përzihen me ta, në mënyrë që krijesat të gjejnë ndriçim pranë dritës së tyre ndërsa realitetet e tyre janë të patrazuara⁴ dhe sekretet e tyre të brendshme janë të mbrojtura⁵.

¹ Ajeti bën fjalë për zgjerimin e furnizimit dhe të fëmijëve.

² Ata sillen sikurse njerëzit e rëndomtë në zakonet dhe shprehitë e tyre, por janë krejtësisht të ndryshëm nga ata në gjendjen e brendshme dhe në mirësjellje.

³ Pejgamberi (alejhi selam) tha:

"Prej jush më të dashurit për mua janë më të mirësjellshmit, që janë të përlulur, të lehtë e të shoqërueshëm. Prej jush më të urryerit për mua janë ata që bartin thashetheme mes njerëzve, ndajnë ata që duhen mes vete dhe kërkojnë ta vejnë në siklet të pafajshmin." (Taberani; kjo mbështetet nga transmetime të tjera të ngjashme të shumta)

⁴ Ata nuk shpërqendrohen nga përzierja me ta.

⁵ Ata nuk zbulojnë raportet e veçanta që kanë me Allahun dhe kërkojnë ta ruajnë këtë.

Një grupi i është zgjeruar për fuqinë e të parit⁶ të tyre dhe për qëndrueshmërinë e vizionit të tyre⁷, meqenëse mprehtësia e tyre nuk trazohet nga shenjat treguese⁸ e as erërat e formave nuk sulmojnë arritjet⁹ e tyre, prandaj këtyre u është zgjeruar Tërheqja (*kabd*)¹⁰.

Një grupi i është zgjeruar që të jenë bajrakë të shtegut, imamë të udhëzimit, dhe pishtarë për udhëtarët.

⁶ Të parit e tyre të realiteteve përtej imazheve dhe përfundimisht shikimin në të Vërtetin me sytë e zemrave të tyre.

⁷ Vizioni i tyre depërtoi të gjitha të ndryshueshmet, kështu që fituan imunitet ndaj ndryshimeve.

⁸ Shenjat treguese i çuan ata te dera e Tij dhe, pasi mbërritën, ata nuk u varen më nga ato shenja; ato i lanë në oborr (te dera).

⁹ Format e jashtme dhe dukuritë kalimtare nuk prishin dëlirësinë e arritjeve të tyre shpirtërore.

¹⁰ Ata nuk humbin asnjë nga vlerat e shkallës së *Kabd* (Tërheqjes) para kësaj.